

Siguri

Ekskluzive | Policia e ndal në pikë kontrolli në Gjakovë – 46-vjeçarit i gjendet pistoletë me 23 fishekë në çantë



Sinjali.com

03 Gusht 2026 10:50



Një kontroll rutinë i Policisë në Gjakovë ka çuar në zbulimin e një arme zjarri me municion, duke bërë që një 46-vjeçar të arrestohet nën dyshimin për armëmbajtje pa autorizim.

Sinjali mëson se i dyshuari është **Genc Fetahi** rreth 46 vjeçar.

Sipas burimeve, rasti ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të 3 gushtit, rreth orës 00:30, në rrugën “Skënderbeu” në Gjakovë, ku patrulla policore kishte ngritur një pikë kontrolli.

Gjatë kontrollit është ndaluar një veturë Audi me ngjyrë të bardhë, të cilën e drejtonte Genc Fetahi.

Burimet bëjnë të ditur se, pasi u pyet nga zyrtarët policorë nëse posedonte ndonjë mjet të kundërligjshëm, i dyshuari bashkëpunoi me Policinë dhe u tregoi një çantë që e mbante në trup.

Brenda saj u gjet dhe u sekuestrua një pistoletë e tipit “CD Shadow”, dy karikatorë dhe 23 fishekë të kalibrit 9×19 mm. Sipas raportit policor, karikatorët nuk ishin të vendosur në armë në momentin e kontrollit.

I dyshuari u arrestua dhe u shoqërua në Stacionin Policor në Gjakovë, ku u intervistua lidhur me rastin.

Me konsultim të Prokurorit të Shtetit, ndaj Genc Fetahit është iniciuar procedurë për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Pas përfundimit të procedurave policore, ai është liruar në procedurë të rregullt, ndërsa arma dhe municioni janë sekuestruar në cilësinë e provave materiale. Hetimet për rastin janë në vazhdim.

Shënim: Personat e apostrofuat në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Gjakove

Policia

Të tjera:



Ekskluzive | Tentoi ta nxirrte djaln nga Stacioni Policor – 43-vjeçarja dyshohet se...

Sinjalizime



Ekskluzive | U ndal për tejkalim shpejtësie në Pejë – Policia i gjen marihuanë dhe armë n...

Ekskluzive



Policia kërkon ndihmën e qytetarëve për gjetjen e Xhafer Raçit, i zhdukur që nga 2 korriku

Siguri



Ekskluzive | Bastisja për të shtënat me armë eskalon në Hajvali – dy persona sulmojnë...

Sinjalizime



Ekskluzive | Të shtëna me armë në restorantin “Iliria De Luxe” në Podujevë – 24-vjeçari...

Sinjalizime



Ekskluzive | Arrestohet 49-vjeçari në Gjakovë – Policia i gjen pistoletë “SIG Sauer” dhe fishek...

Sinjalizime



Ekskluzive | Antidroga godet pranë “Sonn Cafe” në Podujevë – arrestohet 26-vjeçari ...

Sinjalizime



Ekskluzive | Babai ia dha armën djalit 16-vjeçar për të shtënë në aheng – Policia bastis shtëpinë...

Sinjalizime

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera